



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**PROJEKTLIGJI PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

**DRAFT LAW ON HIGHER EDUCATION IN THE REPUBLIC OF KOSOVA**

**NACRT ZAKONA O VISOKOM OBRAZOVANJU U REPUBLICI KOSOVA**

<p>Kuvendi i Republikës së Kosovës, Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Miraton:</p> <p><b>LIGJ PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS</b></p> <p><b>Neni 1 Qëllimi</b></p> <p>Qëllimi i Ligjit të Arsimit të Lartë është krijimi i bazës ligjore për rregullimin, funksionimin, financimin, sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në përputhje me standardet evropiane si dhe rolin e shtetit dhe shoqërisë në zhvillimin e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.</p> <p><b>Neni 2 Parimet</b></p> <p>1. Ofrimi i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës bazohet në parimet si në vijim:</p>	<p>Assembly of the Republic of Kosova, Based on Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosova, Approves:</p> <p><b>LAW ON HIGHER EDUCATION IN THE REPUBLIC KOSOVA</b></p> <p><b>Article 1 Purpose</b></p> <p>The purpose of the Law on Higher Education is to establish a legal basis for the regulation, functioning, financing, quality assurance in higher education in compliance with European standards as well as the role of state and society in development of higher education in the Republic of Kosova.</p> <p><b>Article 2 Principles</b></p> <p>1. Provision of higher education in the Republic of Kosova is based in the following principles:</p>	<p>Skupština Republike Kosova U skladu sa članom 65 (1) Ustava Republike Kosovo, Usvaja:</p> <p><b>ZAKONO VISOKOM OBRAZOVANJU U REPUBLICI KOSOVO</b></p> <p><b>Član 1 Cilj</b></p> <p>Cilj Zakona o visokom obrazovanju je stvaranje zakonske osnove za regulisanje, funkcionisanje, obezbeđivanje kvaliteta visokog obrazovanja u skladu sa međunarodnim evropskim standardima kao i o ulozi države i društva u razvoju visokog obrazovanja u Republici Kosovo.</p> <p><b>Član 2 Načela</b></p> <p>1. Pružanje visokog obrazovanja u Republici Kosovo je zasnovano na sledeća načela:</p>
---	--	--

<p>1.1. Lirinë akademike, të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe interpretimin e saj të mëtutjeshëm nga ana e gjyqësorit;</p> <p>1.2. Barazinë para ligjit për të gjithë bartësit e arsimit të lartë;</p> <p>1.3. Mundësi të barabarta për të gjithë studentët dhe personelin në institucionet e arsimit të lartë pa diskriminim;</p> <p>1.4. Shumëllojshmëri dhe cilësi në programe të studimit dhe në mbështetje të mësimnxënies;</p> <p>1.5. Kreativitet, inovacion dhe ndërmarrësi si objektiva kyçe për bartësit e arsimit të lartë dhe të programeve të studimit;</p> <p>1.6. Fokusim evropian dhe ndërkombëtar në të gjitha fushat e arsimit të lartë që i sigurojnë studentit dhe personelit lëvizshmëri dhe krahasueshmëri të standardeve në dhënie e diplomave dhe kualifikimeve;</p>	<p>1.1. Academic freedom, determined in the Constitution of the Republic of Kosovo and its further interpretation from the judiciary;</p> <p>1.2. Equality before the law for all bearers of higher education;</p> <p>1.3. Equal opportunities for all students and staff in higher education institutions without discrimination;</p> <p>1.4. Diversity and quality in study programmes and in support of learning.</p> <p>1.5. Creativity, innovation and entrepreneurship as key objectives for bearers of higher education and study programs;</p> <p>1.6. European and international focus in all areas of higher education, that provide student and staff mobility and comparability of standards in granting of diplomas and qualifications;</p>	<p>1.1. Akademska sloboda, određena Ustavom Republike Kosovo i njihova dalja interpretacija od strane sudstva;</p> <p>1.2. Ravnopravnost pred zakonom za sve nosioce visokog obrazovanja;</p> <p>1.3. Ravnopravne mogućnosti za sve studente i osoblja u institucijama visokog obrazovanja bez diskriminacije.</p> <p>1.4. Raznolikosti i kvalitet u studijskih programa i podrška nastavnog učenja;</p> <p>1.5. Kreativnost, inovacija i preduzetništvo kao ključni objektivi za nosioce visokog obrazovanja i studijske programe;</p> <p>1.6. Evropski i međunarodni fokus u svim oblastima visokog obrazovanja koje obezbeđuje studentu i osoblju mobilnost i upoređivanost standarda u dodeli diploma kvalifikacija;</p>
---	--	--

<p>1.7. Përkushtim në punë kërkimore dhe akademike për të mbështetur mësimdhënien dhe mësimnxënien si dhe për të zgjeruar kufijtë e njohurive brenda Kosovës dhe jashtë saj;</p> <p>1.8. Angazhim aktiv të studentëve si në aspektin individual, ashtu edhe në atë kolektiv, në jetën e institucionit dhe në mësimnxënien e tyre.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 3 Përkufizimet</b></p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. <b>Akreditim</b> - njohje formale se një institucion i arsimit të lartë dhe programet e tij, i plotësojnë standardet ndërkombëtarisht të pranuar të cilësisë dhe se kualifikimet e tij u japin bartësve të tyre, në pajtim me ligjin në fuqi, një numër të drejtash, siç janë mundësia për qasje në një nivel të mëtejshëm arsimor, profesione specifike dhe për të përdorur një titull;</p> <p>1.2. <b>Mbrojtje e të dhënave</b> - dhe emërtimet në lidhje me to kanë kuptimin e bashkëngjitur atyre në Ligjin nr. 2009-</p>	<p>1.7. Commitment in research and academic work to support teaching and learning and to extend the boundaries of knowledge and understanding within Kosovo and abroad;</p> <p>1.8. Active engagement of students, both in the individual and in the collective aspect, in the life of institution and in their own learning;</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 3 Definitions</b></p> <p>1. Terms used in this Law shall have this meaning:</p> <p>1.1. <b>Accreditation</b> - formal recognition that an institution of higher education and its programmes fulfil internationally recognized quality standards and that its qualifications give their bearers, in accordance with applicable law a number of rights, e.g. opportunity for access to a further education level, specific occupations and to use a title.</p> <p>1.2. <b>Data protection</b> - and denominations in relation to them have the attached meaning to those in the</p>	<p>1.7. Odanost u istraživačkom i akademskom radu za podršku nastavi i učenju kao i povećanje njegovih kapaciteta znanja unutar i van Kosova;</p> <p>1.8. Aktivno angažovanje studenata kao u individualnom tako i u kolektivnom aspektu, u institucionanlnom životu i njihovo učenje;</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 3 Definicije</b></p> <p>1. Izrazi upotrebljeni u ovom zakonu imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1. <b>Akreditacija</b> - formalno priznanje institucije visokog obrazovanja i njene programe ispunjavaju međunarodno priznate standarde kvaliteta i da njihove kvalifikacije dajuse njihovim nosiocima, u skladu sa zakonom na snazi, određeni broj prava kao što je mogućnost pristupa daljeg nivoa obrazovanja, specifične profile za upotrebu određene titule.</p> <p>1.2. <b>Zaštita podataka</b> - i imenovanje u vezi njih imaju značenje priložen kao u Zakon br. 2009-172 o zaštiti ličnih</p>
--	--	--

<p>172 për mbrojtjen e të dhënave personale;</p> <p><b>1.3. Rrjeti Evropian i Qendrave për Informim–ENIC</b> - rrjeti evropian i qendrave për informim, të cilat ofrojnë informacione për njohjen e diplomave, titujve dhe kualifikimeve të tjera ndërkombëtare, për sistemin arsimor, si për vendet e huaja, ashtu edhe për vetë vendin anëtar të këtij rrjeti si dhe për mundësitë e studimit jashtë vendit, duke përfshirë edhe pagesat dhe bursat dhe këshilla për çështje praktike në lidhje me lëvizshmërinë dhe barasvlerën;</p> <p><b>1.4. Sistemi Evropian i Transferimit dhe i Akumulimit të Kredive (ECTS)</b> - cakton kreditë për komponentët e kursit, të bazuara në ngarkesën në punën e studentëve që kërkohet për të arritur objektivat e një drejtimi të veçantë të studimit;</p> <p><b>1.5. Zonë evropiane e arsimit të lartë</b> - ka kuptimin e përcaktuar në deklaratën e ministrave evropianë të arsimit të lartë në Bolonjë (1999);</p> <p><b>1.6. Sigurim i brendshëm i cilësisë</b> - vlerësimi formal i proceseve, përmes të</p>	<p>Draft Law 2009-172 on the Protection of Personal Data.</p> <p><b>1.3. European Network of Information Centre - ENIC</b>- the European Network of Information Centres, which provide information on the recognition of diplomas, degrees and other international qualifications, for the education system as for foreign countries, as well as the country member of this network; and opportunities for studying abroad, including information on loans and scholarships, and advice on practical questions related to mobility and equivalence;</p> <p><b>1.4. The European Credit Transfer and Accumulation System (ECTS)</b> - assigns credits for the course components based on the student workload required to achieve the objectives of the particular course of study.</p> <p><b>1.5. European Area of Higher Education</b> - has the meaning set forth in the Declaration of the European Ministers of Higher Education in Bologna (1999).</p> <p><b>1.6. Internal quality assurance</b>- the formal evaluation of processes by which</p>	<p>podataka.</p> <p><b>1.3. Evropska mreža centra za informacije /ENIC</b> - evropski centar mreža za informisanje, koje pružaju informacije o priznavanju diploma, titula i ostale međunarodne kvalifikacije; za obrazovni sistem, kao za strane zemlje, tako i za zemlju članice ove mreže kao i za mogućnost studiranja van zemlje, obuhvatajući plaćanja i stipendije i savete za praktično pitanje u vezi pokretljivosti i jednako vrednosti.</p> <p><b>1.4. Evropski sistem prenosa i akumulacije kredita (ECTS)</b> - određuje kredite za komponente kursa, zasnovane na opterećenom radu studenata koja se zahteva da postignu objektivne u određenom smeru studije.</p> <p><b>1.5. Evropska zona visokog obrazovanja</b> - ima značenje određeno deklaracijom evropskih ministara za visoko obrazovanje u Bolonji (1999).</p> <p><b>1.6. Unutarnje obezbeđivanje kvaliteta</b> - formalno ocenjivanje procesa, pomoću</p>
---	--	--

<p>cilëve bartësi siguron vetveten se oferta e tij (qoftë ajo e programeve apo e shërbimeve) i plotëson standardet që korrespondojnë me praktikën më të mirë evropiane dhe që tregojnë përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>1.7. <b>Rezultatet e të nxënit</b> - arritjet në nxënie dhe shprehjet në terma të asaj se çka pritet që nxënësi të dijë, të kuptojë dhe të jetë në gjendje të bëjë pas përfundimit të shkallës së studimeve apo të modulit. Aty mund të përfshihen edhe qëndrimet, sjelljet, vlerat dhe etika;</p> <p>1.8. <b>Të mësuarit gjatë gjithë jetës</b> - arsimimi i përgjithshëm, arsimimi dhe aftësimi profesional, arsimimi joformal dhe nxënia informale, të ndërmarra gjatë gjithë jetës, duke rezultuar në ngritjen e njohurive, shkathtësive dhe të kompetencave brenda perspektivës personale, shoqërore, sociale apo asaj të punësimit;</p> <p>1.9. <b>NARIC - Qendra shtetërore për njohje dhe informim akademik (për Kosovë ose për ndonjë vend tjetër).</b> – NARIC- Kosova, ndihmon në promovimin e lëvizshmërisë së</p>	<p>a bearer assures itself that his offer (whether of programs or of services) meets standards which correspond to European best practice and that show continuous improvement.</p> <p>1.7. <b>Learning results-</b> achievement in learning and are expressed in terms of what the student expected to know, to understand and be able to do on completion of the scale of studies or of module. There could also be included attitudes, behaviours, values and ethics;</p> <p>1.8. <b>Life-long learning</b> - all general education, vocational education and training, non-formal education and informal learning, undertaken throughout life, resulting in an improvement in knowledge, skills and competences within a personal, societal, social and that of employment.</p> <p>1.9. <b>NARIC - National Academic Recognition Information Centre (for Kosova or any other country).</b> – NARIC – Kosova, assists in promoting the mobility of students, teachers and</p>	<p>kojog nosioci obezbeđuju sebe da njegova ponuda ( bilo da je programska ili uslužna) ispunjava standarde koje odgovaraju najboljim evropskim praksama i pokazuju neprekidno poboljšanje.</p> <p>1.7. <b>Rezultati učenja</b> - postizanje u učenju i izražavanju njihovih termina što se očekuje od učenika da zna, da razume i da bude u stanju da to uradi po završetku stepena studiranja ili modula.Tu mogu biti obuhvaćeni i stavovi, ponašanje, vrednosti i etika.</p> <p>1.8. <b>Učenje tokom celog života</b> - opšte obrazovanje, profesionalno obrazovanje i osposobljavanje, neformalno obrazovanje i informalno učenje, tokom čitavog života, rezultirajući povećanje znanja, veština i nadležnosti unutar lične, društvene, socijalne perspektive ili u zapošljavanju.</p> <p>1.9. <b>NARIC - Državni centar za priznavanje i akademsko informisanje (za Kosovo ili druge države).</b> NARIC Kosova pomaže u promovisanju mobilnsot studenata,</p>
---	--	--

<p>studentëve, mësimdhënësve dhe hulumtuesve, duke ofruar këshilla dhe informacione kompetente në lidhje me njohjen akademike të diplomave dhe të periudhës së studimeve, të ndërmarra në shtete të tjera. Vendimet mbi njohjen dhe barasvlerën merren nga Këshilli shtetëror për njohje në pajtim me standardet evropiane;</p> <p>1.10. <b>Arsimi parauniversitar</b> - u referohet programeve formale shkollore të MASHT-it, të rregulluara përmes legjislacionit në fuqi;</p> <p>1.11. <b>Bartës jopublik</b> - çdo institucion i themeluar qoftë për fitim ose jofitimprurës nga cilido person, grup personash apo organizatë tjetër përveç Qeverisë së Republikës së Kosovës apo të ndonjë shteti tjetër sovran. Kur një bartës jopublik është krijuar dhe vepron sipas parimit të joprofitabilitetit, ai mund të marrë formën e një organizate joqeveritare dhe të gëzojë të mirat dhe detyrimet përkatëse, të një OJQ-je, në pajtim me legjislacionin në fuqi;</p> <p>1.12. <b>Program</b> - program studimi që shpie në një kualifikim ose diplomë, që</p>	<p>researchers by providing advices and competent information regarding to academic recognition of diplomas and study period, undertaken in other States. Decisions on recognition and equivalency are taken from the State Council for Recognition in compliance with the European standards;</p> <p>1.10. <b>Pre-university education</b> - refers to formal school programmes of MEST regulated by the legislation in force.</p> <p>1.11. <b>Non-public bearer</b> - every institution established whether for profit or unprofitable by any person, group of persons or organization other than the Government of the Republic of Kosova or any other sovereign State. When a non-public bearer is established and operates under the principle of unprofitably, it may take the form of a Non-Governmental Organization and enjoy the benefits and relevant obligations of an NGO in compliance with the legislation in force.</p> <p>1.12. <b>Programme</b> – the course of study that leads to a qualification or diploma</p>	<p>nastavnika i istraživača, pružajući savete i nadležne informacije u vezi sa akademskim priznanjem diploma i perioda studiranja, preduzeta u drugim državama. Rešenja o priznavanju i ekvivalentnost dodeljuje Državni saveta za priznanje u skladu sa evropskim standardima.</p> <p>1.10. <b>Preduniverzitetsko obrazovanje</b> - odnosi se na formalne školske programe MONT-a, regulisane pomoću Zakone na snazi.</p> <p>1.11. <b>Privatni nosilac</b> - svaka osnovana institucija bilo da je profitabilan ili neprofitabilan od bilo koje osobe, grupu osoblja ili druge organizacije osim Vlade Republike Kosova ili neke druge suverene države. Kada određeni privatni nosilac je osnovan i deluje prema neprofitabilnom principu, on može dobiti formu nevladine organizacije i da uživa dobrobiti i dotična zaduženja jedne NVO, u skladu sa zakonima na snazi.</p> <p>1.12. <b>Program</b> – studijski program koji vodi ka kvalifikaciji ili diplomi, koja se</p>
--	--	--

<p>jepet nga një bartës i arsimit të lartë;</p> <p>1.13. <b>Bartës</b> - çdo institucion ose organ tjetër i autorizuar për ofrimin e shërbimeve arsimore në nivelin e arsimit të lartë;</p> <p>1.14. <b>Bartës publik</b> - bartës i themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës;</p> <p>1.15. <b>Partneriteti publiko-privat</b> mund të themelohet për të ofruar shërbime të arsimit të lartë. Formimi i tij do të jetë në përputhje me parimet e barazisë së trajtimit, mosdiskriminimit, transparencës, përpjesëtimin, efektshmërisë së kostos, efikasitetit, mbrojtjes së interesit publik, lirisë së konkurrencës dhe të vlerës së fituar për para si dhe do të jetë në përputhje me Ligjin për partneritetet publiko-privat dhe koncesionet në infrastrukturë si dhe me procedurat për dhënie të tyre (Ligji -03/L-090, qershor 2009);</p> <p>1.16. <b>Organ akreditues i njohur</b> - Agjencia Kosovare e Akreditimit apo ndonjë organ i ngjashëm i tillë, i cili në Zonën evropiane të arsimit të lartë, është aktualisht i anëtarësuar në rrjetin</p>	<p>given by a bearer of a higher education;</p> <p>1.13. <b>Bearer</b> – every institution or other authorized body for provision of educational services in the higher education level;</p> <p>1.14. <b>Public bearer</b> - bearer established by the Government of Republic of Kosova.</p> <p>1.15. <b>Public-private partnership</b> - may be established to provide higher education services. Its formation will be in accordance to the principles of equality of treatment, non-discrimination, transparency, proportionality, cost-effectiveness, efficiency, protection of the public interest, freedom of competition and earned value for money and will conform to the Law on public-private Partnership and concessions in infrastructure as well as the Procedures for their issuance (Law 03/L-090, June 2009).</p> <p>1.16. <b>Recognized accreditation body</b> - Kosova Accreditation Agency or any such similar body which in the European Area of Higher Education, is currently membership in the European Network</p>	<p>dodeljuje nosioc visokog obrazovanja.</p> <p>1.13. <b>Nosilac</b> - podrazumeva svaku instituciju ili drugi organ ovlašćen za pružanje obrazovne usluge na nivo visokog obrazovanja.</p> <p>1.14. <b>Javni nosilac</b> - nosilac zasnovan od strane Vlade Republike Kosova.</p> <p>1.15. <b>Javno-privatno partnerstvo</b> - može se osnovati za pružanje usluge visokog obrazovanja. Njegovo formiranje biće u skladu sa principima ravnopravnog tretmana, bez diskriminacije, transparentnosti, proporcionalnost, efikasnog iznosa, zaštitnu efektivnosti, zaštiti javnog interesa, slobodne konkurencije i dobijene novčane naknade kao i da bude u skladu sa Zakonom za javno-privatno partnerstvo i koncesije u infrastrukturi kao i sa procedurama za njihovo dodeljivanje (Zakon -03/L-090, juni 2009).</p> <p>1.16. <b>Priznati organ za akreditaciju</b> - Kosovska agencija za akreditaciju ili slični organ, koji je u Evropskoj zoni visokog obrazovanja, trenutno učlanjen u evropskoj mreži za bezbednost</p>
---	---	--



<p>evropian për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë /ENQA/, ose (në Shtetet e Bashkuara), është një organ akreditues i cili është i njohur nga Këshilli i akreditimit për arsimin e lartë /CHEA/ apo nga Departamenti i Arsimit i Shteteve të Bashkuara /USDE/ apo nga të dyja, ose (në cilindo juridiksion tjetër) është pranuar nga Ministria në baza të ndërsjella si një organ i themeluar në mënyrë të duhur shtetëror a rajonal i akreditimit, që njihet dhe është i autorizuar nga ministria relevante në kuadër të atij juridiksioni.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 4</b> <b>Objektivat dhe organizimi i arsimit të lartë</b></p> <p>1. Objektivat e arsimit të lartë janë:</p> <p>1.1. Krijimi, zhvillimi, mbrojtja dhe transmetimi i njohurive përmes mësimdhënies dhe punës kërkimore e shkencore;</p> <p>1.2. Përgatitja e studentëve për studime të mëtejshme, praktikë profesionale dhe për të mësuarit gjatë gjithë jetës, me anë të përvetësimit dhe zhvillimit të</p>	<p>for Quality Assurance in Higher Education (ENQA) or (in the United States) is an accreditation body which has been recognized by the Council for Higher Education Accreditation (CHEA) or by the United States Department of Education (USDE) or from both or (in any other jurisdiction) has been accepted by the Ministry on a reciprocal basis as a properly constituted national or regional accrediting body, which is recognized and authorized by the relevant Ministry within that jurisdiction.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 4</b> <b>Objectives and organization of Higher Education</b></p> <p>1. The objectives of higher education are:</p> <p>1.1. Creation, development, protection and transmission of knowledge through teaching and scientific and research works;</p> <p>1.2. Preparation of students for further studies, professional practice and lifelong learning through the acquisition and knowledge development in-depth</p>	<p>kvaliteta u visokom obrazovanju /ENQA/ ili ( u Sjedinjenim Američkim Državama), je organ za akreditaciju a koje je priznat od Saveta za akreditaciju visokog obrazovanja /CHEA/ili od strane Departamenta za obrazovanje Sjedinjenih Američkih Država ili od obadvije, ili (u bilo kom drugom zakonodavstvu) priznat je od strane Ministarstva na recipročnoj osnovi kao organ zasnovan na valjan državni i regionalni način za akreditaciju, koji je priznat i ovlašćen je od strane relevantnog ministarstva u okviru svog zakonodavstva</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 4</b> <b>Ciljevi i organizovanje visokog obrazovanja</b></p> <p>1. Objektivni visokog obrazovanja su:</p> <p>1.1. Stvaranje, razvoj, zaštita i prenošenje znanja pomoću predavanja i naučno istraživačkog rada;</p> <p>1.2. Priprema studenata za dalje studije, profesionalnu praksu i učenje u toku celogživota, pomoću usvajanja i razvijanja specijalističkih produbljeno</p>
---	--	--

<p>njohurive të thelluara dhe kompetencave të nivelit të lartë;</p> <p>1.3. Ofrimi i mundësive për të gjithë banorët e Kosovës që janë të aftë për të përfituar nga ky arsimim dhe për t'i kontribuar shoqërisë dhe vendit të tyre gjatë gjithë jetës .</p> <p>2. Arsimi i lartë organizohet, si vijon:</p> <p>2.1. Niveli i parë - tre (3) deri katër (4) vite studime me të cilat studenti arrin 180, përkatësisht 240 kredi/ ECTS dhe merr diplomën Bachelor;</p> <p>2.2. Niveli i dytë – një (1) deri dy (2) vite studime pas mbarimit të nivelit të parë me të cilat studenti arrin 60, përkatësisht 120 kredi /ECTS dhe studenti merr diplomën Master;</p> <p>2.3. Niveli i tretë - programe të studimeve të doktoratës me karakter akademik dhe hulumtues-shkencor të pavarura;</p> <p>2.4. Çdo arsimim tjetër pas shkollës së mesme në nivelet 5, 6, 7 dhe 8 të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve për të mësuarit gjatë gjithë jetës, për të</p>	<p>and high level competences;</p> <p>1.3. Offering of opportunities to all inhabitants of Kosova who are capable to benefit from this education and to society and their country, throughout lives.</p> <p>2. Higher education is organized, as follows:</p> <p>2.1. First level – three (3) to four (4) years of studies by which the student reaches 180, respectively 240 credits /ECTS/, and obtains Bachelor Diploma.</p> <p>2.2. Second level – one (1) to two (2) years of studies after completion of the first level by which the student reaches 60, respectively 120 credits /ECTS/ and the student obtains Master Diploma.</p> <p>2.3. Third level – programme of doctorate studies with academic and independent research scientific character.</p> <p>2.4. Any other post-secondary education in levels 5, 6, 7 and 8 of the European Qualifications Framework for Lifelong Learning, for which credits may be</p>	<p>znanja i kompetencije visokog nivoa</p> <p>1.3. Pružanje mogućnosti za sve stanovnike Kosova koji su sposobni da stiču korist iz ove nastave i da doprinesu svom društvu i državi tokom celog života.</p> <p>2. Visoko obrazovanje organizuje se kao to sledi:</p> <p>2.1. Prvi nivo - tri (3) do četiri (4) godine studije kojima student postiže 180, odnosno 240 kredita/ ECTS i dobija diplomu Bachelor.</p> <p>2.2. Drugi nivo - jedna (1) do dve (2) godine studija nakon završetka prvog nivoa kojima student postiže 60, odnosno 120 kredita/ECTS i student dobija diplomu Master.</p> <p>2.3. Treći nivo - programi studija doktorata sa nezavisnim akademskim i naučno istraživačkim karakterom .</p> <p>2.4. Svako drugo obrazovanje nakon srednje škole na nivoima 5, 6, 7 i 8 Evropskog okvira za kvalifikacije za učenje u toku celog života, za koji se</p>
--	---	---

<p>cilin mund të jepen kredi (ECTS).</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b> <b>Qasja në arsimin e lartë</b></p> <p>1. Në arsimin e lartë që ofrohet nga bartësit e licencuar të arsimit të lartë në Kosovë, do të kenë qasje të gjithë personat brenda apo jashtë territorit të Kosovës, pa asnjë lloj diskriminimi.</p> <p>2. Nuk do të ketë kufizim moshe për t'u regjistruar apo për të fituar kualifikim të arsimit të lartë në Kosovë.</p> <p>3. Bartësi i arsimit të lartë që është i akredituar në Kosovë, sipas këshillës së NARIC- Kosova, mund të pranojë një kualifikim shtetëror apo ndërkombëtar ose një diplomë shtetërore a ndërkombëtare si të barasvlershme me certifikatën e maturës, e cila përcaktohet në këtë ligj. Në rastin e paraqitjes për vlerësim të një certifikate për mbarimin e shkollimit në një shtet tjetër, njohja, përveç në raste të jashtëzakonshme, do të bëhet vetëm për certifikatën që tregon përfundimin e së paku 12 viteve të shkollimit dhe që i jep të drejtën pronarit të saj për të aplikuar në universitet apo për të hyrë në testin pranues në universitet në shtetin e huaj përkatës.</p>	<p>given (ECTS).</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 5</b> <b>Access to Higher Education</b></p> <p>1. In higher education that is provided by licensed bearers of higher education in Kosova, will have access all persons in and outside the territory of Kosova, without any kind of discrimination.</p> <p>2. There shall be no age limit on enrolling or to earn higher education qualification in Kosova.</p> <p>3. Higher education bearer that is accredited in Kosova according to NARIC-Kosova advices, may accept a national or international qualification or state or international diploma as equivalent to the graduation certificate, which is defined in this Law. In the case presented for evaluation of a certificate for completion of education in another state, recognition, other than in exceptional cases, shall be made only for the certificate showing completion of at least twelve (12) years of education and that gives its owner the right to apply in university or to enter the acceptance test in university in the foreign country concerned.</p>	<p>moгу dati krediti (ECTS).</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 5</b> <b>Pristup visokom obrazovanju</b></p> <p>1. Visoko obrazovanje koja se nudi od strane licenciranih nosioca visokog obrazovanja na Kosovu biće pristupačno za sve osobe unutar ili van teritorije Kosova, bez nikakve vrste diskriminacije.</p> <p>2. Neće biti ograničenja starosti za upis ili dobijanja kvalifikacije u visokom obrazovanju na Kosovu.</p> <p>3. Nosilac visokog obrazovanja koji je akreditovan na Kosovu, na osnovu preporuke NARIC Kosova, može primiti državnu ili međunarodnu kvalifikaciju ili diplomu državnu ili međunarodnu kao ekvivalentnu sa certifikatom mature, koji se određuje u ovom zakonu. U slučaju podnošenja zahteva za evaluaciju certifikata o završenom školovanju u drugoj državi, priznanje osim u izuzetnim slučajevima, vršiće se samo za certifikate koji dokazuju završavanje najmanje dvanaest 12 godina školovanja i koji daje pravo vlasniku da nastavi školovanje na univerzitet ili da pristupi na prijemnom testu na univerzitetima dotičnoj stranoj</p>
---	--	--

<p>4. Një kualifikim, diplomë ose përvojë shtetërore a ndërkombëtare mund të pranohet si e barasvlershme me shkallën Baçellor, të cekur në nënparagrafin 2.1. paragrafi 2. i nenit 4 të këtij ligji nga bartësi i arsimit të lartë, i akredituar në Kosovë sipas këshillës së NARIC Kosova. Në rastin e paraqitjes për vlerësim të një certificate të marrë nga një institucion i arsimit të lartë, duhet të jetë i akredituar nga një organ akreditues i njohur, siç është përkufizuar në nenin 3 të këtij ligji.</p> <p>5. Arsimi i lartë mund të vijohet në mënyrë të rregullt, me korrespondencë, përmes të mësuarit në distancë dhe me kombinim të cilësdo prej këtyre mënyrave të studimit, ashtu sikurse parashihet në statutin e bartësit që jep kualifikim të arsimit të lartë.</p> <p>6. Asgjë në këtë ligj ose në instrumentet plotësuese të nxjerra sipas tij, apo në dispozitat e çfarëdo ligji tjetër, nuk do të kufizojnë lirinë e bartësve të licencuar të arsimit të lartë:</p> <p>6.1. Për të sjellë risi në arsimin e lartë në përputhje me kushtet e përcaktuara në licencat e tyre;</p>	<p>4. A qualification, diploma or state or international experience may be accepted as equivalent to the Bachelor degree, referred to in sub-paragraph 2.1. paragraph 2 of Article 4 of this Law by a higher education provider accredited in Kosovo on the advice of NARIC Kosova. In the case presented for assessment to obtain a certificate from an institution of higher education, must be accredited from a known accredited body as defined in Article 3 of this Law.</p> <p>5. Higher education can be pursued full-time, part-time, through distance learning and the combination of any of these ways of study, as it is foreseen in the bearer's statute that gives higher education qualification.</p> <p>6. Nothing in this law or additional instruments issued under it, or the provisions of any other law, shall not restrict the freedom of licensed higher education bearers:</p> <p>6.1. To bring innovation in higher education in compliance with the requirements of their licenses and</p>	<p>državi</p> <p>4. Kvalifikacija, diploma ili međunarodno ili državno iskustvo može biti priznato kao ekvivalentno nivo Bečalar, navedeno u članu pod stavu 2.1. stav 2. člana 4 ovog zakona od strane akreditovanog nosioca visokog obrazovanja, na Kosovu. U slučaju podnošenje zahteva za procenu certifikata dobijenog od strane institucije visokog obrazovanja, treba biti akreditovan od strane poznatog organa za akreditaciju, kao što je definisano u gore-navedenom članu 3. ovog zakona.</p> <p>5. Visoko obrazovanje može se pohađati redovno, vanredno pomoću učenje na distanci i kombinacijom bilo kojeg načina ovakvog studiranja, tako kao što se predvđa statutom nosioca koji daje kvalifikacije za visoko obrazovanje.</p> <p>6. Ništa u ovom zakonu ili dodatnim instrumentima na osnovu njega, ili na osnovu bilo koje druge odredbe zakona, neće ograničiti slobodu licenciranih nosioca visokog obrazovanja:</p> <p>6.1. Za uvođenje novosti u visoko obrazovaje u skladu sa uslovima određenim u njihovim licencama</p>
--	--	--

<p>6.2. Për të ofruar kurse të çdo niveli arsimor për përvetësimin e aftësive që janë të nevojshme apo të përshtatshme për realizimin e qëllimeve të arsimit të lartë dhe për dhënien e kontributit në të mësuarit gjatë jetës.</p> <p>7. Arsimi i lartë mund të ofrohet nga çdo bartës i licencuar i arsimit të lartë, pa kufizim për sa i përket kohëzgjatjes apo strukturës së vitit shkollor, me kusht që të mund t'ia dëshmojë në mënyrë të kënaqshme një organi akreditues të njohur se diplomat e tij plotësojnë standardet e pritshme për diploma të tilla brenda Zonës evropiane të arsimit të lartë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Kompetencat dhe përgjegjësitë e Ministrisë në ofrimin e arsimit të lartë</b></p> <p>1. Në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me dokumentet plotësuese të nxjerra mbi bazën e tij dhe të atyre të nxjerra në bazë të nenit 14 të Ligjit për arsim në komunat e Republikës së Kosovës (03-L-068, të majit 2008), Ministria është përgjegjëse për:</p>	<p>6.2. To offer courses of each educational level for the acquisition of skills that are necessary or appropriate for realizing of the goals of higher education and giving the contribution to lifelong learning.</p> <p>7. Higher education may be provided by any licensed higher education bearer, without restriction regarding the duration or the structure of the school year, on condition that they can give evidence in a satisfied manner to a known accredited body that his diplomas meet the expected standards for such diplomas within the European Zone of Higher Education.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 6</b> <b>Competencies and responsibilities of the Ministry in providing the Higher Education</b></p> <p>1. In accordance with the provisions of this law and additional instruments issued under his basis and those issued under Article 14 of the Law on Education in the Republic of Kosova municipalities (03/L-068, May 2008) Ministry is responsible for:</p>	<p>6.2, Da omogući kurseve na svim obrazovnim nivoima za sticanje veštine koje su potrebne ili odgovarajuće za realizaciju ciljeva visokog obrazovanja i za davanje doprinosa u učenju tokom celog života.</p> <p>7. Visoko obrazovanje može nuditi svaki nosilac visokog obrazovanja, bez vremenskog ili strukturnog ograničenja školske godine, pod uslovom da može na zadovoljavajući način da dokaže poznati organ za akreditaciju da njegove diplome ispunjavaju očekivane standarde za takve diplome unutar Evropskoj zoni visokog obrazovanja.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 6</b> <b>Nadležnosti i odgovornosti Ministarstva za pružanje visokog obrazovanja</b></p> <p>1. U skladu sa odredbama ovog zakona i dopunskim dokumentima izdata na njegovoj osnovi i one izdate na osnovu člana 14 Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosova (03-L-068, maja 2008), Ministarstvo je odgovorno za:</p>
---	---	--

<p>1.1. Planifikimin e zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë, në konsultim me bartësit e akredituar të arsimit të lartë;</p> <p>1.2. Rregullimin e statusit të bartësve publik dhe privatë të arsimit të lartë dhe miratimin e statuteve të tyre. Statutet e të gjitha universiteteve dhe të cilitdo aplikues për titull “universitet“ duhet të ratifikohen nga Kuvendi;</p> <p>1.3. Ndarjen e fondeve bartësve të arsimit të lartë për qëllime të mësimdhënies dhe të hulumtimit në interesin publik në kuadër të dispozitave të përgjithshme të ligjit të zbatueshëm për financimin e shërbimeve publike në Kosovë dhe duke siguruar që fondet e tilla janë shpenzuar në përputhje me prioritetet e dakorduara ndërmjet Ministrisë dhe çdo bartësi nëpërmjet instrumenteve të financimit, të specifikuara në formën e aktit nënligjor;</p> <p>1.4. Autorizimin e formatit dhe përmbajtjes së Diplomës dhe të Shtojcës së diplomës, në bashkëpunim me Agjencinë Kosovare për Akreditim, të cilat lëshohen nga bartësit e akredituar të arsimit të lartë, të</p>	<p>1.1. Development planning of higher education in Kosova, in consultation with the accredited bearers of higher education;</p> <p>1.2. The status adjustment of public and private bearers of higher education and approving their Statutes. The Statutes of all Universities and of any applicant for “University” title must be ratified by the Assembly;</p> <p>1.3. Allocation of funds to higher education bearers for purposes of teaching and research in the public interest within the general provisions of applicable law for financing of public services in Kosova and ensuring that such funds are spent in accordance with agreed priorities between the Ministry and each bearer through financing instruments, specified in the form of sub-legal act;</p> <p>1.4. Authorization of the format and content of Diploma and Diploma Supplement, in cooperation with the Kosova Accreditation Agency, which are issued by accredited bearers of higher education, defined with sub-legal</p>	<p>1.1. Planiranje i razvoj visokog obrazovanja na Kosovu, uz konsultaciju sa akreditiranim nosiocima visokog obrazovanja;</p> <p>1.2. Regulisanje statuta javnih i privatnih nosioca visokog obrazovanja i usvajanje njihovih statuta. Statuti svih univerziteta i bilo kojeg podnosioca zahteva za titulu ‘univerzitet’ mora ratifikovati Skupštine;</p> <p>1.3. Dodela fondova nosiocima visokog obrazovanja u cilju predavanja i istraživanja u cilju javnog interesu u okviru opšti odredbi primenjenog zakona o finansiranju javnih usluga na Kosovu obezbedivši da su ti fondovi potrošeni u skladu sa usaglašenim prioritetima između među Ministarstva i svakog nosioca pomoću instrumente za finansiranje, specifikovanih u obliku podzakonskih akata.</p> <p>1.4. Autorizacija formata i sadržaja Diplome i Dodatak diplome, u saradnji sa Kosovskom agencijom za akreditaciju, koje se izdaju akreditovani nosioci visokog obrazovanja, određene podzakonskim</p>
---	--	---

<p>përcaktuar me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria;</p> <p>1.5. Dhënie e propozimeve lidhur me krijimin e një skeme ose skemave për mbështetjen financiare të studentëve dhe rregullimin e administrimit të një skeme apo skemave të tilla;</p> <p>1.6. Promovimin e lëvizjes së studentëve dhe të personelit brenda Zonës evropiane dhe asaj ndërkombëtare të arsimit të lartë si dhe inkurajimin për përdorimin e gjuhës angleze për mësim krahas gjuhëve zyrtare. Vendosjen e rregullave lidhur me njohjen akademike dhe profesionale, në përputhje me standardet evropiane, qoftë përmes NARIC Kosova brenda Ministrisë, ose përmes Agjencisë Kosovare për Akreditim dhe informimi i publikut për statusin e kualifikimeve të huaja përmes ENIC- Rrjetit evropian të qendrave për informim;</p> <p>1.7. Promovimin e mundësive të barabarta në qasjen dhe pranimin në arsimin e lartë, në zhvillimin dhe trajnimin e personelit, në mundësitë për të mësuar gjatë gjithë jetës dhe në të</p>	<p>act issued by the Ministry;</p> <p>1.5. Giving of proposals regarding with creation of a scheme or schemes for student financial support and adjustment of administration of a scheme or such schemes;</p> <p>1.6. Mobility promotion of students and of personnel within the European and International Zone of Higher Education as well the encouragement for use of English language to learn alongside the official languages. Setting the rules regarding the academic and professional recognition, in compliance with European standards, either through NARIC Kosova within the Ministry or through Kosova Accreditation Agency and informing the public for the foreign qualifications status through ENIC-European Network Information Centres;</p> <p>1.7. Promotion of equal opportunities in access and admission to higher education, in development and training of personnel, in possibilities for lifelong learning and in all other aspects of</p>	<p>aktima izdatih od strane Ministarstva ;</p> <p>1.5. Predlaganje u vezi stvaranja jedne šeme ili šeme za finansijsku pomoć studentima i administrativno regulisanje jedne šeme ili takvih šema;</p> <p>1.6. Promovisanje kretanja studenata i osoblja unutar Evropske i međunarodne zone visokog obrazovanja kao i podsticaj za upotrebu Engleskog jezika u učenju pored službenih jezika. Uspostavljanje pravila u vezi akademskih i profesionalnih priznanja, u skladu sa evropskih standarda bilo pumoću NARIC Kosova unutar Ministarstva ili preko Kosovske agencije za akreditaciju i informisanje javnosti za status stranih kvalifikacija preko ENIC Evropska mreža centara za informisanje;</p> <p>1.7. Promovisanje jednakih mogućnosti u pristup i prijem u visokom obrazovanju, u razvoju i obuku osoblja, za mogućnosti učenja tokom celog života i u svim ostalim aspektima</p>
---	---	--

<p>gjitha aspektet e tjera të arsimit të lartë.</p> <p>1.8. Krijimin e Këshillit shtetëror për arsimin e lartë, i cili këshillon Ministrin për çështje të arsimit të lartë, duke caktuar termat dhe referencat e tij si dhe për emërimin e anëtarëve;</p> <p>1.9. Promovimin e lidhjeve midis bartësve publik të arsimit të lartë në Kosovë, bartësve privatë të arsimit dhe aftësimin, industrisë dhe tregtisë si dhe për inkurajimin e zhvillimit të ndërmarrësisë;</p> <p>1.10. Promovimin e lidhjeve midis të gjithë bartësve të arsimit të lartë në Kosovë dhe institucioneve të arsimit të lartë në rajonin dhe më gjerë.</p> <p>1.11. Licencimin e bartësve të arsimit të lartë;</p> <p>1.12. Sigurimin e ndihmesës, në përputhje dhe këtë ligj, për bartësit e akredituar të arsimit të lartë dhe studentëve të regjistruar aty;</p> <p>1.13. Rregullimin e të gjitha çështjeve të tjera lidhur me arsimin e lartë, të cilat nuk janë të rregulluara veçmas në</p>	<p>higher education;</p> <p>1.8. Establishment of the State Council for Higher Education, which advises the Minister on higher education matters, by setting terms and references, as well as for the members appointment;</p> <p>1.9. Promotion of links between public higher education bearers in Kosovo, private bearers of education and training, industry and trade, as well as for encouraging the development of entrepreneurship;</p> <p>1.10. Promotion of links between all higher education bearers in Kosovo and higher education institutions in the region and beyond;</p> <p>1.11. Licensing of higher education bearers;</p> <p>1.12. Providing of assistance in compliance with this Law, for accredited bearers of higher education and of enrolled students there;</p> <p>1.13. Adjustment of all other matters regarding to higher education, which are not separately regulated according to this</p>	<p>visokog obrazovanja;</p> <p>1.8. Stvaranje državnog saveta za visoko obrazovanje koji savetuje Ministarstvu u vezi visoko obrazovanje, određivši njegove teme i preporuke kao i imenovanje članova;</p> <p>1.9. Promovisanje veza među javnim nosiocima visokog obrazovanja na Kosovu, privatnim nosiocima obrazovanje i osposobljavanje industrije i trgovine kao i za podsticanje razvoja i preduzetništva;</p> <p>1.10. Promovisanje veza među svim nosiocima visokog obrazovanja na Kosovu i institucijama visokog obrazovanja u regionu i šire;</p> <p>1.11. Licenciranje nosioca visokog obrazovanja;</p> <p>1.12. Pružanje pomoći u skadu sa ovim zakonom, za akreditovane nosioce visokog obrazovanja i njihove studentie.</p> <p>1.13. Regulisanje sva ostala pitanja u vezi visoko obrazovanje, koje nisu regulisane posebno na osnovu ovog</p>
--	--	--



<p>bazë të këtij ligji;</p> <p>1.14. Ndërmarrja e veprimeve për menaxhimin e situatave të cilat pengojnë dhe rrezikojnë funksionalitetin e institucioneve të arsimit të lartë.</p> <p>2. Në ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të saj në bazë të këtij ligji, Ministria respekton dhe promovon të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre, të përcaktuara në Ligjin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë (Ligji nr. 03/L-047, mars 2008).</p>	<p>law.</p> <p>1.14.Undertaking actions for management of situations that obstruct and endanger the functioning of higher education institutions – HEI.</p> <p>2. In exercising responsibilities and its duties according to this Law, the Ministry respects and promotes the rights of Communities and their members, established in the Law for Protection and Promotion of the Community Rights and their Members in Kosova (Law No. 03/L-047, March 2008)</p>	<p>zakona.</p> <p>1.14. Preduzimanje delovanja u menadžiranju situacije koje ometaju i rizikuju funkcionalnost institucija visokog obrazovanja.</p> <p>2. U sprovođenju svoje odgovornosti i zadatke na osnovu ovoga zakona, Ministarstvo poštuje i promovise pravo zajednica i njihovih članova, određene Zakonom o zaštiti i promovisanju prava zajednice i njihovih članova na Kosovu (Zakon br. 03/L-047, mart 2008).</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b> <b>Agjencia e Kosovës për Akreditim</b></p> <p>1. Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), është agjenci e pavarur përgjegjëse për vlerësimin dhe promovimin e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë. Përmes proceseve profesionale dhe transparente të vlerësimit dhe kontrollit të cilësisë apo mjeteve të tjera që konsiderohen të përshtatshme nga ajo, të cilat i plotësojnë praktikrat më të mira ndërkombëtare, AKA siguron që standardet dhe cilësia e arsimit</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 7</b> <b>Kosova Accreditation Agency</b></p> <p>1. Kosova Accreditation Agency (KAA), is an independent agency responsible for assessment and promotion of higher education quality in Kosova. Through professional and transparent processes of quality assessment and quality audit or other means that are considered appropriate from it, which meet international best practices, KAA ensures that the standards and quality of higher</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 7</b> <b>Kosovska agencija za akreditaciju</b></p> <p>1. Kosovska Agencija za akreditaciju (KAA) je nezavisna agencija odgovorna za ocenjivanje i promovisanje kvaliteta u visoko obrazovanje na Kosovu. Putem profesionalne i transparentne procese za ocenivanje i kontrolu kvaliteta ili drugim sredstvima koje se smatraju adekvatnim za to, koje ispunjavaju najbolje međunarodne prakse, KAA obezbeđuje da kvalitet standarda u visokom obrazovanje na</p>

